



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 384, datë 02.10.2020

PËR
KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...}
DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE TË EMËRIMIT NË GJYKATËN E POSAÇME TË
APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR DY
POZICIONET E LIRA, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 88 DHE NR. 90, DATË
26.02.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “d”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja, znj. Marçela Shehu,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të emërimit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për dy pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 88 dhe nr. 90, datë 26.02.2020.
2. Vendimi nr. 208, datë 18.06.2020, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR